



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

Ministri

5563
Nr. ... Prot.

Tiranë, më 23.07.2015

MIRATOHET

MINISTRI


LINDITA NIKOLLA



KORNIZA E VLERËSIMIT TË NXËNËSIT NË ARSIMIN
PARAUNIVERSITAR

Tiranë, korrik 2015

PËRMBAJTJA LËNDËS

1. KUPTIMI PËR VLERËSIMIN	4
2. PARIMET THEMELORE	5
2.1 Vlefshmëria.....	5
2.2 Transparenca	5
2.3 Paanshmëria.....	5
2.4 Besueshmëria	5
3. LLOJET E VLERËSIMIT	6
3.1 Vlerësimi i brendshëm.....	6
3.2 Vlerësimi i jashtëm	7
4. ÇFARË VLERËSOJMË?	7
4.1 Aspektet e të nxënësit.....	7
4.2 Standardet dhe pritshmëritë	8
4.3 Vlerësimi i shtrirjes, i sfidave dhe zbatimit të të nxënësit	8
4.4 Vlerësimi i përparimit dhe i arritjeve të të nxënësit	9
4.5 Aftësitë gjuhësore dhe matematikore	10
5. KUR VLERËSOJMË?	10
5.1 Vlerësimi i vazhdueshëm si pjesë e të nxënësit dhe mësimdhënies.....	11
5.2 Vlerësimi periodik	11
5.3 Vlerësimi përfundimtar	12
6. SI VLERËSOJMË?	12
6.1 Përdorimi i evidencave për vlerësim.....	12
6.2 Përshtatshmëria e vlerësimit me rezultatet që synohen	13
6.3 Diskutime, detyra dhe aktivitete	15
6.4 Vlerësimi i të nxënësit ndërkurrikular	17
6.5 Regjistrimi i progresit dhe arritjeve.....	18
7. SIGURIMI I CILËSISË DHE BESUESHMËRIA NË VLERËSIM	18

7.1	<i>Zhvillimi i vlerësimit përmes standardeve</i>	18
7.2	<i>Verifikimi në sigurimin e cilësisë</i>	20
7.3	<i>Tiparet e sigurimit të cilësisë dhe moderimit në vlerësim.....</i>	20
7.4	<i>Mbështetja e vlerësimit përmes udhëzuesve dhe zhvillimit profesional të vazhduar</i>	21
8.	RAPORTIMI I PROGRESIT DHE ARRITJEVE TË NXËNËSVE.....	23
8.1	<i>Përshkrimi i progresit dhe i arritjeve.....</i>	24
9.	ROLET DHE PËRGJEGJËSITË NË VLERËSIM	26
9.1	<i>Nxënësit</i>	26
9.2	<i>Mësuesit dhe stafi drejtues</i>	27
9.3	<i>Prindërit</i>	28
9.4	<i>Autoritetet arsimore</i>	28
10.	FJALORI I VLERËSIMIT TË NXËNËSIT	30

GRUPI I PUNËS NË IZHA

SOTIR RRAPO

DORINA RAPTI

YLLKA SPAHIU


EVIS MASTORI

ERIDA KOLECI

1 KUPTIMI PËR VLERËSIMIN

Vlerësimi në arsim është procesi gjatë të cilit mblidhen të dhëna dhe gjykohet për vlerën e arritjes së një rezultati arsimor, mbi bazën e një kriteri të caktuar.

Qëllimi kryesor i vlerësimit është marrja e vendimeve që synojnë përmirësimin e rezultateve të të nxënës dhe vetë procesin e të nxënës. Marrja e vendimeve kërkon grumbullimin e vazhdueshëm të informacionit për të matur dhe për të vlerësuar të gjitha aspektet e procesit. Praktikat e vlerësimit kanë ndikim vendimtar në procesin e të nxënës.



Vlerësimi për të nxënës (VpN). Synimi kryesor i këtij vlerësimi është të mbikëqyrë përparimin e nxënës gjatë procesit të të nxënës dhe të mbledhë informacion për të lehtësuar dhe për të ndihmuar marrjen e vendimeve për të përmirësuar këtë proces.

Vlerësimi i të nxënës (ViN). Synimi kryesor i këtij vlerësimi është të përcaktojë arritjet në përfundim të një detyre të caktuar, të kapitullit, të vitit shkollor etj., për të vendosur notat dhe për të certifikuar nxënës për nxënie të mëtejshme. Ai përdoret edhe për të gjykuar efektivitetin e të nxënës ose të programit mësimor.

2 PARIMET THEMELORE

Vlerësimi bazohet në parime të caktuara, si:

2.1 Vlefshmëria

Vlerësimi duhet të sigurojë informacion të vlefshëm për proceset, për rezultatet dhe për vlerat që zhvillohen nga nxënësit gjatë procesit të arsimimit në nivele të ndryshme.

2.2 Transparenca

Nxënësit kanë të drejtë dhe nevojë të njihen me kriteret dhe metodat me të cilat do të vlerësohen. Kjo garanton paanshmërinë e vlerësimit dhe ndihmon të nxënësit. Kriteret e qarta dhe të hapura ndihmojnë gjykimet profesionale, si dhe sigurojnë që vendimet të shqyrtohen nga të gjithë dhe të jenë të qëndrueshme.

2.3 Paanshmëria

Vlerësimi i paanshëm nënkupton vlerësimin e një rezultati të nxënësit, duke mos u ndikuar nga karakteristikat dhe rrethanat e çdo nxënësi, të cilat përfshijnë: gjininë, etninë, gjuhën, racën, rrethanat ekonomike e shoqërore, vendndodhjen, si dhe personalitetin, talentin, aftësitë e kufizuara etj.

2.4 Besueshmëria

Gjykimet për përparimin e nxënësve duhet të bazohen në lloje dhe burime të ndryshme informacioni. Informacioni i marrë nga vlerësimi duhet të tregojë në mënyrë të besueshme, nëse nxënësi është në gjendje të realizojë atë çfarë përshkruhet në rezultatet e nxënësit. Integrimi i llojeve dhe i burimeve të ndryshme të të dhënave të mbledhura gjatë një periudhe të caktuar kohore dhe në situata të ndryshme është kusht i domosdoshëm për të siguruar gjykime të qëndrueshme dhe të paanshme për arritjet e nxënësve.

3 LLOJET E VLERËSIMIT

Gjatë vlerësimit gjykohet dhe merren vendime për përparimin e vazhdueshëm dhe për nivelin e arritjes së rezultateve të të nxënës, të përcaktuara në kurrikulën bërthamë, si dhe në planet e programet mësimore. Përmes vlerësimit merret informacion sa më i plotë dhe tërësor për shkallën e zotërimit dhe të demonstrimit të kompetencave nga nxënësit.

Llojet kryesore të vlerësimit arsimor janë:

- Vlerësimi i brendshëm
- Vlerësimi i jashtëm

3.1 Vlerësimi i brendshëm

Vlerësimi i brendshëm realizohet nga mësuesit dhe drejtuesit e shkollës, në veprimtarinë e përditshme mësimore dhe edukative. Ky vlerësim përdor mjete të ndryshme që mundësojnë nxjerrjen në pah të nivelit të zotërimit të kompetencave, konkretisht:

- gjerësinë dhe thellësinë e të nxënës të përvetësuar;
- gatishmërinë për t'iu përgjigjur sfidave të nivelit dhe për të përparuar drejt të nxënës edhe më sfidues;
- zbatimin e të nxënës në situata dhe rrethana të reja.

Vlerësimi i nxënësve, përveç formave të ndryshme joformale gjatë gjithë procesit të të nxënës, bëhet edhe nëpërmjet shkallës së vlerësimit që përfshin notat 4 - 10.

Nota 4: Një arritje që tregon performim të pamjaftueshëm të njohurive të reja dhe të kompetencave.

Nota 5: Një arritje që tregon performim minimal të njohurive të reja dhe të kompetencave.

Nota 6: Një arritje që tregon performim të mjaftueshëm të njohurive të reja dhe të kompetencave.

Nota 7: Një arritje që tregon performim të kënaqshëm të shumicës së njohurive të reja dhe të kompetencave.

Nota 8: Një arritje që tregon performim të mirë të njohurive të reja dhe të kompetencave.

Nota 9: Një arritje që tregon performim shumë mirë të njohurive të reja dhe të kompetencave.

Nota 10: Një arritje që tregon performim të shkëlqyer dhe origjinal të njohurive të reja dhe të kompetencave.

Vlerësimi i arritjes së rezultateve të të nxënësit bëhet gjatë dhe në fund të çdo viti shkollor dhe dëshmon nivelin e arritjeve të tyre nga nxënësit.

3.2 Vlerësimi i jashtëm

Me vlerësim të jashtëm do të kuptohet vlerësimi i realizuar nga autoritetet qendrore, rajonale e vendore të arsimit (MAS, AKP, ISHA, DAR/ZA).

Vlerësimi i jashtëm mund të bëhet për qëllime:

- Inspektimi dhe verifikimi të cilësisë së vlerësimit në nivel klase, shkolle apo bashkie;
- Vlerësimi të standardizuar në nivele arsimore;
- Hulumtimi;
- Vendimmarrjeje në nivele, fusha dhe aspekte të ndryshme në arsim.

Vlerësimet e standardizuara shtetërore organizohen në përfundim të nivelit arsimor.

4 ÇFARË VLERËSOJMË?

4.1 Aspektet e të nxënësit

Të nxënësit e planifikuar realizohet në kontekste, mjedise dhe mënyra të ndryshme. Kontekstet përfshijnë etosin dhe jetën e shkollës si komunitet, fushat e të nxënësit dhe lëndët përkatëse, të

nxënit ndërkurrikular dhe mundësitë individuale. Ato përfshijnë të nxënit, si brenda ashtu edhe jashtë mjediseve shkollore.

Vlerësimi fokusohet në zbatimin e standardeve dhe pritshmërive të progresit dhe arritjes së nxënësve në:

- njohuritë,
- shkathtësitë,
- qëndrimet dhe vlerat,

që janë përcaktuar në kurrikulën shkollore.

4.2 Standardet dhe pritshmëritë

Standardet dhe pritshmëritë jepen në formën e rezultateve të të nxënit në kurrikul, për nivele dhe shkallë, të cilat duhet të arrihen nga të gjithë nxënësit.


Vlerësimi duhet t'i aftësojë dhe t'i motivojë të gjithë nxënësit për të zhvilluar potencialin e tyre në të gjithë kurrikulën.

Nxënësit mund të përparojnë me ritme të ndryshme: disa kërkojnë mbështetje dhe kohë për të arritur rezultatet e të nxënit në një ose disa fusha/lëndë në një shkallë të caktuar; disa të tjerë përparojnë më shpejt dhe kërkojnë detyra më të avancuara dhe pavarësi në të nxënë.

4.3 Vlerësimi i shtrirjes, i sfidave dhe i zbatimit të të nxënit

Qasja e zgjedhur për vlerësimin duhet t'i ndihmojë nxënësit për të treguar përparimin e tyre sipas niveleve dhe për t'i aftësuar ata të demonstrojnë arritjet në mënyra të ndryshme, të përshtatshme me të nxënit. Ata duhet të tregojnë se:

- kanë **zgjeruar** të nxënit përmes përvojave dhe rezultateve në një aspekt të kurrikulës;
- mund t'i përgjigjen nivelit të **sfidave të të nxënit** për ta çuar atë më përpara;
- mund të **zbatojnë** atë që kanë mësuar në situata të reja dhe të panjohura për ta.



Mësuesit duhet të punojnë së bashku për të kuptuar më mirë rezultatet e të nxënit, duke organizuar dhe marrë pjesë në veprimtari të përbashkëta profesionale. Shembujt pozitivë në vlerësim duhet të bëhen objekte të diskutimit dhe përhapjes së përvojës në nivel kombëtar.

Është e rëndësishme që nxënësit të kenë mundësi të demonstrojnë arritjet e tyre në mënyra të ndryshme. Shkollat duhet të kenë fleksibilitetin e zgjedhjes së mënyrave të ndryshme të vlerësimit në varësi të nevojave të nxënësve dhe mundësive të komunitetit. Ato duhet t'u japin liri nxënësve të zgjedhin mënyrën se si do t'i demonstrojnë arritjet e tyre.

4.4 Vlerësimi i përparimit dhe i arritjeve të të nxënit

Brenda një niveli nxënësit duhet të demonstrojnë besueshmëri, zotërim dhe siguri në tri aspekte të nxëni, si:

- Gjerësia e të nxënit
- Aspektet sfiduese
- Zbatimi i të nxënit në situata të reja dhe të panjohura


4.5 Aftësitë gjuhësore dhe matematikore

Zhvillimi i aftësive gjuhësore dhe matematikore merr rëndësi të veçantë në kurrikulën e arsimit bazë. Të gjithë mësuesit kanë përgjegjësi për zhvillimin e tyre. I rëndësishëm është zhvillimi i këtyre aftësive, sidomos në moshën e hershme.

5 KUR VLERËSOJMË?

Qëllimi kryesor i vlerësimit është të mbështesë të nxënësit dhe kjo arrihet më së miri nga kombinimi i vlerësimit për të nxënësit VpN (formues) dhe vlerësimi i të nxënësit ViN (përmbledhës). Kjo do të thotë që vlerësimi bëhet në mënyrë të vazhdueshme, si dhe me intervale të rregullta për të evidentuar arritjen dhe progresin e nxënësve. Termat “formues” dhe “përmbledhës” nuk përshkruajnë një lloj apo formë të vlerësimit, por përshkruajnë se si janë përdorur vlerësimet.

Evidencat dhe përfundimet nga çdo vlerësim mund të përdoren për të përmirësuar planifikimin e mësimdhënies, për përmbledhjet periodike të progresit dhe të arritjeve, të cilat kontribuojnë për raportim dhe monitorim.



5.1 Vlerësimi i vazhdueshëm si pjesë e të nxënësit dhe e mësimdhënies

Mësuesit vlerësojnë vazhdimisht, pasi vlerësimi është pjesë e të nxënësit dhe e mësimdhënies së përditshme. Ata e bëjnë këtë, duke dëgjuar dhe duke vëzhguar nxënësit gjatë kryerjes së detyrave, duke vëzhguar atë që shkruajnë dhe bëjnë, duke marrë parasysh përgjigjet e pyetjeve etj. Ata përpiqen të njihen më mirë me nxënësit e tyre, të ndërtojnë një profil të progresit të tyre, të njohin pikat e forta dhe nevojat, të cilat i përfshijnë në planifikimin e orës së ardhshme të mësimit.

Vlerësimi i vazhdueshëm për të nxënësit është efektiv, kur nxënësit e dinë ku janë me të nxënës të tyre, si dhe çfarë duhet të bëjnë më tej për ta përmirësuar atë. Është e rëndësishme që mësuesit të përdorin evidenca për të nxënësit e nxënësve, pasi ato sigurojnë informacione të dobishme për të përshtatur qasjet e të nxënësit me mësimdhënien sipas nevojave të nxënësve, si dhe ndihmojnë në rishikimin e përmbajtjes mësimore në ato raste kur të nxënësit nuk është ende në rezultatet e pritshme.

Vlerësimi i vazhdueshëm bëhet edhe për të vlerësuar përparimin e nxënësve në të gjithë gjerësinë e të nxënësit, sfidat e të nxënësit dhe në zbatimin e tij në kontekste të ndryshme dhe të panjohura.

5.2 Vlerësimi periodik

Herë pas here, në mënyrë periodike, mësuesit evidentojnë progresin dhe arritjet e nxënësve me qëllim monitorimin dhe raportimin e tyre. Kjo është thelbësore sepse siguron informacion nëse përparimi i nxënësve është në rrugën e duhur apo duhen ndërmarrë hapa për zgjidhjen e ndonjë problemi të mundshëm. Ky vlerësim i referohet rezultateve të të nxënësit për një nivel të kurrikulës, për një periudhë të caktuar ose për një/disa kompetenca të fushës/lëndës. Mësuesit e realizojnë këtë vlerësim me anë të vlerësimit të vazhduar nëpërmjet evidencave të mbajtura, testeve/detyrave përmbledhëse për një periudhë të caktuar kohore sipas planifikimit 3-mujor dhe dosjeve të nxënësve.

5.3 Vlerësimi përfundimtar

Vlerësimi përfundimtar, i planifikuar mirë dhe efektiv, është thelbësor për progresin e nxënësit në lidhje me zotërimin e kompetencave kyçe dhe të kompetencave të fushës/lëndës. Ky vlerësim përfshin:

- kalimin në klasën pasardhëse;
- kalimin në shkallën pasardhëse;
- kalimin në nivelin shkollor pasardhës.

Modalitetet e vlerësimit përfundimtar rregullohen me udhëzime të veçanta të MAS-it.

Vlerësimi përfundimtar duhet të nxisë vazhdimësinë dhe përparimin në të nxënë. Për të siguruar informacionin e nevojshëm për vlerësim, duhet të përfshihen të gjithë mësuesit, prindërit dhe nxënësit. Partneriteti mes tyre është i rëndësishëm për mirëqenien e nxënësve dhe progresin e tyre.

Sigurimi i cilësisë dhe drejtësia në vlerësimin përfundimtar ka rëndësi të veçantë pasi promovon standarde dhe kompetenca edhe në sektorë të tjerë të shoqërisë.

6 SI VLERËSOJMË?

Siç e kemi përmendur edhe më lart, vlerësimi përfshin mbledhjen, reflektimin dhe mbajtjen e evidencave mbi të nxënësit e nxënësve për t'u mundësuar mësuesve kontrollin e përparimit të tyre.

6.1 Përdorimi i evidencave për vlerësim

Mësuesit duhet të përdorin mënyra të ndryshme të matjes së arritjeve të nxënësve, pasi kështu u krijohet mundësia nxënësve për të treguar atë që dinë, kuptojnë dhe mund të bëjnë. Gama dhe shumëllojshmëria e qasjeve të vlerësimit duhet të marrë parasysh rëndësinë e konteksteve dhe të përvojave të mëparshme, interesat dhe aspiratat e nxënësve duke vendosur lidhje me të gjithë të nxënësit.

Është thelbësore që mësuesit të përdorin evidenca për të nxënësit për t'u siguruar nëse nxënësit po përparojnë. *Evidencat janë të ndryshme në varësi të llojit të të nxënësit që do të vlerësohet dhe plotësohen në mënyrë të vazhdueshme, periodike për detyra specifike, punë të nxënësve, aktivitete, teste etj.*

Vlerësimi duhet të planifikohet si pjesë e aktiviteteve mësimore dhe e mësimdhënies. Në planifikimin e aktiviteteve me nxënësit, mësuesit:

- duhet të marrin parasysh dhe të paraqesin rezultatet e të nxënësit, për të cilat nxënësit janë duke punuar;
- duhet të japin shembuj që ilustrojnë rezultatet e pritshme;
- duhet të përcaktojnë kriteret e suksesit përmes diskutimeve ndërmjet tyre dhe me nxënësit;
- duhet të krijojnë mundësi që nxënësit të demonstrojnë njohuritë, të kuptuarin, afësitë dhe qëndrimet e tyre.

Mësuesit duhet të marrin në konsideratë balancën ndërmjet njohurive, të kuptuarit, shkathtësive, qëndrimeve, kompetencave, ashtu siç përshkruhet në rezultatet e të nxënësit.

6.2 *Përshtatshmëria e vlerësimit me rezultatet që synohen*

Gjykimet rreth të nxënësit duhet të jenë të vlefshme dhe të besueshme.



Vlefshmëria e vlerësimit varet nga vlerësimi i gjerësisë së të nxënësit të programit mësimor dhe nga gama e evidencave të përdorura për mbledhjen e konkluzioneve. Vlerësimet duhet të jenë të drejta, të arsyeshme, të përshkruajnë të nxënësit e synuar dhe të bazohen në kriteret e shëndosha. Vlefshmëria përmirësohet, kur detyrat dhe aktivitetet e vlerësimit masin rezultatet e synuara dhe lejojnë nxënësit të tregojnë dhe demonstrojnë njohuritë e tyre, të kuptuarit, shkathtësitë dhe

qëndrimet. Aktivitetet e vlerësimit duhet t'u mundësojnë nxënësve që të tregojnë “sa mirë” dhe “sa shumë” kanë mësuar gjatë zhvillimit të programit mësimor.

Besueshmëria është shkalla në të cilën vlerësimi, nëse përsëritet, do të japë të njëjtin rezultat. Vlerësimet janë të besueshme nëse ofrojnë evidenca me cilësi të lartë dhe informacione që janë të krahasueshme (d.m.th., vlerësimi ka besueshmëri, kur gjykimet e të gjithë nxënësve, konteksteve, departamenteve apo shkollave janë të krahasueshme). Në besueshmërinë e një vlerësimi ndikojnë shumë faktorë, si p.sh., qartësia e udhëzimeve se si nxënësit të demonstrojnë të nxënit e tyre etj. Besueshmëria dhe qëndrueshmëria e vendimeve të mësuesve rritet nëse mësuesit bashkëpunojnë njeri me tjetrin për standardet dhe rezultatet e pritshme.

Gjithashtu, e rëndësishme është që vlerësimi të jetë **proporcional**. Proporcionaliteti shmang mbingarkesën e nxënësve dhe të mësuesve dhe u krijon atyre mundësitë që ta përdorin me efikasitet kohën për mësimdhënie dhe të nxënë.

Të gjitha vlerësimet duhet të jenë të vlefshme, të drejta për të gjithë nxënësit dhe të mbështesin progresin në të nxënit e tyre. Vlerësimi mund të përdoret:


- për të ndërtuar të kuptuarit tek nxënësit “si pjesë e të nxënit dhe e mësimdhënies”;
- për të monitoruar dhe ndjekur progresin e të nxënit në shkollë;
- për të dhënë informacion mbi arritjet e nxënësve;
- për t'u dhënë informacion aktorëve të tjerë jashtë shkollës (p.sh., në raste të dhënies së çmimeve).

Të gjitha vlerësimet që sigurojnë përmbledhje të progresit dhe arritjeve të nxënësve për aktorë jashtë shkollës kërkojnë kredibilitet dhe për këtë arsye duhet të kenë vlefshmëri dhe besueshmëri të lartë.

Si pjesë e planifikimit, mësuesit duhet të diskutojnë dhe të ndajnë me kolegët qasjet vlerësuese për të siguruar përshtatshmërinë e tyre për rezultatin e synuar (vlefshmërinë), si dhe nëse këto vlerësime zbatohen në mënyrë të drejtë dhe të qëndrueshme për të gjithë nxënësit (besueshmëria).

6.3 Diskutime, detyra dhe aktivitete

Vlerësimi është pjesë e procesit të të nxënës dhe e mësimdhënies dhe duhet planifikuar si i tillë. Mësuesit duhet të planifikojnë diskutime efektive, detyra dhe aktivitete në mënyrë që nxënës të demonstronin të nxënës të tyre. Ata duhet të sigurohen që vlerësimi është i përshtatshëm me rezultatet e synuara, duke konsideruar me kujdes faktorët kryesorë të vlerësimit. Mësuesit duhet ngrenë çështjet e mëposhtme dhe të diskutojnë rreth tyre:



Diskutimet, detyrat dhe aktivitetet e përzgjedhura nga mësuesit, që nxënësit të dëshmojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre, mund të kryhen brenda shkollës dhe jashtë saj. Mësuesit duhet të bashkëpunojnë me nxënësit për përcaktimin e qasjes më të përshtatshme të vlerësimit për një ose disa rezultate të nxëni.

Si burime për evidencat dhe për dosjen e nxënësit mund të shërbejnë:

- formate vëzhgime të nxënësve që kryejnë detyra dhe aktivitete, si p.sh., hulumtime praktike, shfaqje, prezantime, diskutime etj.;

- dokumente, materiale, të dhëna (me gojë, shkrim, audio-vizuale) të krijuara nga nxënësit, të cilat mund të përfshijnë vetëvlerësim dhe/ose vlerësim ndërmjet nxënësve ose mund të vlerësohen nga mësuesit;
- informacion i marrë nëpërmjet pyetësorëve me cilësi të lartë ndërveprimi dhe dialogëve;
- përgjigje me shkrim;
- një krijim artistik, krijim letrar, projekt, raporte etj.;
- raportime të siguruara nga të tjerë (prindërit, nxënës të tjerë, mësues të tjerë) për atë që kanë bërë nxënësit.

Mësuesit duhet të përdorin mënyra vlerësimi, të cilat shmangin ndonjë pengesë të panevojshme si p.sh., vështirësitë në nivelin e gjuhës së përdorur etj. Ata duhet të zgjedhin të dhënat e përshtatshme që masin arritjet, si dhe formatet përkatëse, të hartuara nga agjenci të posaçme për këtë punë, të cilat përmbajnë atë që nxënësit duhet të dinë, të shkruajnë, të bëjnë, të prodhojnë për të treguar sukses, si p.sh: përgjigjet e pritshme të pyetjeve, shkathtësitë dhe qëndrimet që duhet të demonstrojnë, kriteret e suksesit për prezantimet dhe produktet etj.

Mësuesi duhet të sqarojnë nxënësit se çfarë duhet të bëjnë për detyra ose teste vlerësimi specifike. Atyre duhet t'u krijohen mundësitë që të demonstrojnë një sërë kompetencash, për shembull një shkallë të lartë të të menduarit, aftësi për të punuar me të tjerët, sipërmarrje etj.

6.4 Vlerësimi i të nxënësit ndërkurrikular

Planifikimi i kujdesshëm i të nxënësit ndërkurrikular krijon mundësi për kuptimin dhe zbatimin e njohurive dhe të shkathtësive në situata të panjohura duke marrë përsipër sfida të reja. Ai mund të realizohet jo vetëm në klasë, por edhe në kontekste të ndryshme, me përfshirjen e partnerëve nga komuniteti. Vlerësimi i të nxënësit ndërkurrikular duhet të planifikohet me kujdes me qëllim që të sigurohet vlefshmëria dhe besueshmëria e tij. Ai duhet të përqendrohet në përvojat dhe rezultatet e identifikuar brenda dhe nëpër fusha të caktuara kurrikulare, me fokus të veçantë sigurimin e progresit në njohuri dhe kompetenca.

6.5 Regjistrimi i progresit dhe i arritjeve

Është e rëndësishme që mësuesit të mbajnë të dhëna të përditësuara rregullisht për progresin dhe arritjet e nxënësve. Këto duhet të bazohen në evidencat e të nxënësve. Nxënësit dhe mësuesit duhet të zgjedhin shembujt më të mirë (“më e fundit” dhe “më e mira”) të arritjeve të tyre. Pjesa më e madhe e regjistrimeve (mbajtjeve shënimi) duhet të bëhet gjatë aktiviteteve të përditshme mësimore.

Përveç kësaj, mësuesit duhet të plotësojnë periodikisht profilet e plota të nxënësve, edhe kur ata janë duke kryer një hulumtim në një aspekt të veçantë të të nxënësve. Si qasje për regjistrimin e progresit dhe të arritjeve mund të jenë:

- Dëgjimi dhe demonstrimi i përditshëm i të nxënësve dhe i mësidhënies;
- Regjistrimi selektiv dhe i fokusuar në karakteristika thelbësore të performancës.

Regjistrimi efektiv mund të përdoret si fokus i diskutimeve gjatë planifikimit të mësimin për të identifikuar hapat e ardhshëm të të nxënësve. Ai, gjithashtu, ndihmon mësuesit për të siguruar ndihmën e duhur në të nxënësve e secilit prej nxënësve, si dhe mund të përdoret për të prezantuar arritjet me stafin, nxënësit dhe prindërit.

7 SIGURIMI I CILËSISË DHE BESUESHMËRIA NË VLERËSIM

7.1 Zhvillimi i vlerësimit përmes standardeve

Korniza kurrikulare synon të përmbushë arritjen e kompetencave kyçe dhe të kompetencave të fushës për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë në arsimin parauniversitar. Kjo kërkon që të kemi një proces efektiv të sigurimit të cilësisë dhe të moderimit të procesit.

Sigurimi i cilësisë ndihmon për të mbështetur mësuesit, për të ndërtuar ekspertizë dhe kapacitete në sistemin arsimor, për të arritur rezultate pozitive për fëmijët dhe të rinjtë. Nëpërmjet hartimit, mirëkuptimit dhe zbatimit të standardeve dhe të rezultateve të pritshme, sigurimi i cilësisë

ndihmon për të rritur nivelin e qëndrueshmërisë të të gjithë mësuesve dhe shkollave. Sigurimi i cilësisë në arsim është pjesë e punës së përditshme të shkollave, autoriteteve lokale dhe kombëtare. Mësuesit përdorin një gamë të gjerë aktiviteteve për të siguruar mbajtjen e standardeve të larta për fëmijët dhe të rinjtë. Këto aktivitete përfshijnë monitorimin, vetë-vlerësimin dhe planifikimin për përmirësim. Vlerësimi është pjesë integrale e të nxënës, mësimdhënies dhe programit mësimor dhe kjo sjell që qasja e sigurimit të cilësisë të zbatohet në mënyrë të barabartë gjatë vlerësimit.

Sigurimi i cilësisë në mënyrë rigoroze, krijon besim në gjykimet e mësuesve, jep siguri te prindërit dhe të tjerët që të gjithë nxënësit i kanë arritjet e tyre në përputhje me standardet e pranuar kombëtare dhe po ecin në përputhje me pritshmëritë.

Moderimi përdoret për të përshkruar metodat për arritjen e standardeve dhe pritshmërive për të gjithë sistemin arsimor. Ai përfshin mësuesit dhe profesionistë të tjerë, të cilët punojnë së bashku për:

- planin e të nxënës, mësimdhënies dhe vlerësimit;
- përshtatshmërinë e veprimtarive të vlerësimit me mundësitë e nxënësve për të përmbushur standardet dhe pritshmëritë;
- evidencat e thjeshta për punën e nxënësve dhe gjykimet e mësuesve;
- progresin e nxënësve dhe hapat e mëtejshëm në të nxënë;
- ndikimin e konkluzioneve dhe gjyqimeve të mësuesve në përmirësimin e të nxënës.

Moderimi ndihmon për të rritur standardet, pritshmëritë dhe nivelin e qëndrueshmërisë në të gjithë mësuesit dhe shkollat. Kjo siguron që fokusi të jetë në rezultatet e pritshme, të nxënës të jetë në nivelin e duhur, nxënës të zhvillojnë aftësitë për të nxënë, aftësitë për jetën dhe aftësitë për punë, të cilat do t'i lejojnë ata që të jenë të suksesshëm në të ardhmen.

7.2 Verifikimi në sigurimin e cilësisë

Verifikimi është një nga masat për sigurimin e cilësisë që përdoret nga autoritetet arsimore në nivel qendror ose lokal për të konfirmuar se detyrat dhe aktivitetet e vlerësimit u sigurojnë nxënësve mundësi të drejta dhe të vlefshme për të përmbushur standardet. Verifikimi përdoret për të përshkruar qasjen e sigurimit të vlefshmërisë dhe besueshmërisë së vendimeve të autoriteteve lokale në përputhje me standardet kombëtare.

Verifikimi i brendshëm realizohet nga autoritetet lokale. Kjo do të thotë se autoritetet lokale duhet të kenë një sistem të brendshëm të sigurimit të cilësisë, me kontrole efektive të cilësisë në zonën e tyre, për t'u siguruar se vendimet e vlerësimit nga të gjithë mësuesit janë të qëndrueshme për të njëjtën fushë/lëndë.

Verifikimi i jashtëm kryhet nga autoritetet në nivel qendror dhe siguron:

- uniformitetin e standardeve kombëtare të zbatuara;
- qëndrueshmërinë dhe saktësinë e vlerësimeve të zbatuara nga autoritetet lokale dhe në të gjitha nivelet e shkollës;
- ndikimin e konkluzioneve dhe gjykimeve të mësuesve në përmirësimin e të nxënës.

Sistemi i verifikimit siguron që autoritetet qendrore, lokale dhe në nivel shkolle të kenë sisteme të njëjta të sigurimit të cilësisë, të dokumentuara mjaft mirë. Qasjet eficiente dhe efektive për sigurimin e cilësisë dhe moderimin kërkojnë praktika partneriteti në nivel lokal dhe bashkëpunim me autoritetet e tjera në nivel kombëtar.

7.3 Tiparet e sigurimit të cilësisë dhe moderimit në vlerësim

Sigurimi i cilësisë dhe moderimi:

- janë të fuqishëm, rigorozë dhe krijojnë besim në gjykimet dhe vlerësimet e mësuesve;

- ofrojnë mundësi bashkëpunimi për mësuesit për të marrë pjesë në dialog profesional dhe punë kolegjiale;
- sigurojnë drejtësi për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë;
- nxisin besimin e ndërsjellë, pranimin e ideve të ndryshme, respektimin e aftësive të ndryshme, si dhe nxisin shkëmbimin e përvojës që sjellin pjesëmarrësit;
- sigurojnë që të nxënës, mësimdhënja dhe vlerësimi janë planifikuar në mënyrë koherente dhe se vlerësimi është i vlefshëm dhe i besueshëm;
- ofrojnë mundësi për të nxjerrë përfundime dhe për të planifikuar përmirësimin;
- ofrojnë mundësi që metodat e përdorura të jenë të arritshme, të organizohet lehtësisht dialog i vazhdueshëm profesional si element thelbësor;
- promovojnë angazhimin “nxënësi me nxënësin”, të cilët diskutojnë mbi punën e tyre përfshirë edhe identifikimin e strategjive të dobishme për të nxënës e tyre;
- promovojnë ndërtimin e kapaciteteve të ekspertizës së vlerësimit, zhvillimin dhe përmirësimin e cilësisë, si përbërës të proceseve për sigurimin e cilësisë.

Sigurimi i cilësisë dhe moderimi janë, gjithashtu, të rëndësishëm në momentet e kalimit nga një klasë/shkallë/nivel në tjetrin, duke pasur parasysh standardet dhe pritshmëritë përkatëse. Kjo do të sigurojë besimin në vlerësim dhe vlefshmërinë e informacionit në mënyrë që nxënësit të përjetojnë vazhdimësinë dhe përparimin në të nxënës e tyre. Sigurimi i cilësisë duhet të jetë fleksibël, ai varet nga konteksti i secilës shkollë, autoriteti lokal përkatës i arsimit dhe ndërtohet mbi praktikat ekzistuese efektive.

7.4 Mbështetja e vlerësimit përmes udhëzuesve dhe zhvillimit profesional të vazhduar

Mbështetja përmes udhëzuesve

Autoritetet kombëtare dhe lokale punojnë së bashku për të siguruar materiale mbështetëse në të cilat ofrohen udhëzime, sugjerime, shembuj për të nxënës, mësimdhënien dhe vlerësimin që nxisin kreativitetin, duke u bazuar në Kornizën Kurrikulare. Këto udhëzues do të jenë në dispozicion të mësuesve dhe shkollave përmes publikimeve, faqeve online etj.

Qëllimi i këtyre udhëzuesve është të sigurojë mbështetje për një sistem vlerësimi të unifikuar dhe koherent. Ato mbështesin mësuesit në thellimin e të kuptuarit dhe ekspertizën e tyre në vlerësim. Ato, gjithashtu, do të ndihmojnë zhvillimin e kapacitetit të mësuesve për të bërë gjykime të shëndosha rreth progresit dhe arritjeve të nxënësve. Sigurisht që udhëzuesit për vlerësimin do të pasurohen edhe nga Agjencia Kombëtare e Provimeve, Inspektorati Shtetëror i Arsimit etj.

Zhvillimi profesional i vazhduar

Profesioni i mësuesit për shekullin XXI paraqet shpresën e një force profesionale dhe fleksibile mësimore me përgjegjësinë e punës bashkëpunuese dhe me një angazhim për zhvillimin e vazhdueshëm profesional (ZHVP). Zhvillimi i cilësisë së lartë profesionale dhe kolegjaliteti janë të nevojshëm për zbatimin e kurrikulës me bazë kompetencat.

Disa nga tipare të ZHVP-së efektive përfshijnë:

- Secili mësues merr përgjegjësitë për identifikimin e nevojave për ZHVP duke përdorur diskutime dhe duke ndarë ide me kolegë.
- Koordinimin e ZHVP-së në shkollë duke organizuar aktivitete për të ndarë pikat e forta të secilit prej mësuesve të shkollës dhe përdorimin me efektivitet të kualifikimit profesional.
- Rritjen e profesionalizmit nëpërmjet punës së përbashkët, angazhimit në diskutime profesionale dhe duke marrë rol udhëheqës në risi të ndryshme.
- Mësuesit me përvojë mbështesin kolegët më të rinj duke modeluar praktikat më të mira.
- Mentorët mbështesin mësuesit e rinj nëpërmjet ndarjes së eksperiencës dhe profesionalizmit të tyre.
- Aktivitete të organizuara nga autoritete lokale, nëpërmjet rrjeteve profesionale, këshillimeve etj.
- Autoritetet kombëtare identifikojnë nevojat për ZHVP duke u nisur nga rezultatet e të nxënësve për nxënësit.

Nevojat për ZHVP do të plotësohen nëpërmjet një sërë aktiviteteve të organizuara nga vetë institucioni arsimor, do të mbështeten nga autoritetet arsimore lokale dhe kombëtare, organizatave partnere etj.

8 RAPORTIMI I PROGRESIT DHE I ARRITJEVE TË NXËNËSVE

Raportimi i progresit dhe arritjeve të nxënësve ka dy qëllime kryesore:

Së pari siguron informacion të plotë dhe të vazhdueshëm rreth të nxënësve dhe progresit të tyre, duke shërbyer si bazë për të krahasuar arritjet me rezultatet e pritshme të të nxënësve.

Së dyti krijon një platformë e cila u shërben mësuesve dhe prindërve të mbështesin nxënësit në hapat e mëtejshëm të të nxënësve, si dhe vetë nxënësve të zhvillohen në këtë proces.

Informacionet në lidhje me arritjet dhe rezultatet e tjera raportohen për palët e interesit, të cilat përfshijnë nxënësit, prindërit, mësuesit, MAS-in, qeverisjen lokale, institucionet profesionale, shoqërinë civile etj. Forma dhe përmbajtja e raportimit duhet t'i përshtatet nevojave të palëve të interesit dhe të mbështesë përdorimin e informacionit.

Gjatë marrjes së vendimeve për dhënien e informacionit duhet marrë parasysh çfarë informacioni duhet dhënë dhe kujt i duhet ofruar. Për shembull, prindërit duhet të kenë një shkallë të gjerë informacioni rreth shkollimit të fëmijëve të tyre, në mënyrë që t'u vijjnë në ndihmë në përmirësimin e arritjeve, si dhe të marrin vendime rreth progresit të tyre, ndërsa MAS ka nevojë për informacione rreth arritjeve të shkollës në tërësi dhe jo për nxënës të veçantë etj. Në lidhje me këtë duhet shqyrtuar qëllimi, forma, përmbajtja, niveli i detajeve, frekuenca, afati kohor dhe konfidencialiteti i këtij informacioni.

Shkolla duhet të ketë një politikë të mirëpërcaktuar për të siguruar informacionin e vlerësimit për prindërit dhe palët e tjera të interesit. Politika e vlerësimit në shkollë duhet të specifikojë parimet

që zbatohen gjatë vlerësimit, si dhe informacionet që u jepen prindërve dhe palëve të tjera të interesit, të drejtat dhe detyrimet e shkollës, mësuesve, nxënësve dhe prindërve. Mësuesit duhet ta zbatojnë këtë politikë me transparencë, duke siguruar komunikim të mirë mes shkollës dhe prindërve.

8.1 Përshkrimi i progresit dhe arritjeve

Raportimi mbi të nxënit e nxënësve dhe progresin e tyre duhet të marrë parasysh arritjet e nxënësve në mjedise dhe kontekste të ndryshme të të nxënit, përfshirë fushat e të nxënit, jetën dhe etikën e shkollës, të nxënit jashtë shkollës.

Audienca e afërt e raportimit është nxënësi. Nxënësit duhet të inkurajohen dhe të mbështeten që të përfshihen në vendimmarrje në lidhje me të dhënat për rezultatet e tyre. Mësuesit duhet të bashkëpunojnë me nxënësit për të mbledhur të dhëna në lidhje me rezultatet e tyre dhe për t'ia raportuar prindërve.

Raportimi u siguron prindërve informacion të rregullt për arritjet (anët e forta) të fëmijëve të tyre dhe nevojat e zhvillimit, mundësi për të diskutuar me ta mbi progresin në aspekte të ndryshme të kurrikulës, si dhe mundësi për të dhënë mendimin e tyre mbi progresin e fëmijëve. Prindërit duhet të jenë të informuar për çdo boshllëk në progresin e fëmijëve dhe për rrugët përmes të cilave ata mund të mbështeten.

Raportimi i progresit dhe i arritjeve të nxënësve i mundëson stafit t'u vijë në ndihmë prindërve të kuptojnë si mund të mbështesin fëmijët e tyre në procesin e të nxënit.

Nxënësit vetë janë në gjendje të kontribuojnë në diskutimet me prindërit për raportimet dhe për progresin e tyre në të nxënë. Procesi i planifikimit, vlerësimit, regjistrimit dhe njohjes së arritjeve, mund t'u vijë në ndihmë nxënësve të kuptojnë aftësitë dhe cilësitë që zhvillojnë përmes të nxënit të tyre dhe i aftëson ata t'i zhvillojnë më tej.

- *Raportimi duhet të identifikojë përparimin dhe dobësitë, përshkrimin e tyre, si dhe të theksojë pikat strategjike të mundshme për përmirësimin e arritjeve. Dhënia e komenteve mund të jetë me gojë ose me shkrim; ajo duhet të jetë konstruktive dhe pozitive; të identifikojë çfarë ka bërë nxënësi mirë ose jo mirë; çfarë duhet bërë për përmirësim; si duhet bërë; si dhe të sugjerohen hapat e mëtejshëm.*
- *Për t'i ndihmuar prindërit të mbështesin fëmijët e tyre në procesin e të nxënës, është e rëndësishme që mësuesit të ndajnë informacionin e plotë dhe të hapur të progresit të çdo nxënësi. Në momente të veçanta, në mënyrë të veçantë në momentet tranzitore (kalimi nga një klasë në tjetrën, kalimi nga një shkallë e kurrikulës në tjetrën ose kalimi nga një nivel arsimor në tjetrin), mësuesit punojnë me nxënësit për të përmbledhur dhe raportuar arritjet, duke përdorur komente të shkurtra cilësore për të nxënës e planifikuar në fusha të të nxënës dhe në kontekste të ndryshme. Raportimi duhet të theksojë anët e forta, aspektet për zhvillim dhe arritjet në aspektet sfiduese. Përdorimi efikas i informacionit të vlerësimit, me fokus të veçantë planifikimin dhe mbështetjen e të nxënës, është themelor në momentet e tranzicionit. Raportimi duhet të sigurojë njohjen e zhvillimit progresiv të kompetencave.*
- *Gjithashtu, është e rëndësishme që për nxënësit që kërkojnë më shumë zgjedhje dhe më shumë mundësi, apo për nxënësit me nevoja shtesë, raportimi të përshkruajë një balancë të përshtatshme midis thellësisë së të nxënës dhe aspekteve sfiduese. Mësuesit duhet të bëjnë të qartë natyrën e mbështetjes që duhet të ofrohet me qëllim që çdo nxënës të ketë progres.*
- *Transferimi i informacioneve të qarta për progresin e çdo nxënësi, arritjeve dhe mbështetjes është mjaft i nevojshëm. Në nivelin e ardhshëm arsimor, stafi mund ta përdorë këtë informacion për të siguruar që e gjithë puna e mëtejshme të ngrihet mbi të nxënës dhe përvojat e mëparshme të nxënësve.*

Puna në partneritet efektiv rrit vlefshmërinë, besueshmërinë dhe ndan kuptimin për informacionin.

Është e rëndësishme që stafi të reflektojë mbi një sërë burimesh informacioni. Ato duhet të kenë të dhëna të arritjeve të cilat të jenë të vlefshme dhe të besueshme dhe që ndihmojnë në identifikimin e anëve të forta, aspekte të cilat mundësojnë përmirësimet e mëtejshme.

Qëllimet e përdorimit të informacionit janë të njëjta për stade të ndryshme të të nxënësit. Këto qëllime përfshijnë sigurimin e një përmbledhjeje të asaj se çfarë nxënësit kanë arritur me synim mbështetjen e të nxënësit, dhënien e sigurisë prindërve dhe të tjerëve në lidhje me progresin e nxënësve. Informacioni i vlerësimit, gjithashtu, ndihmon për informimin në lidhje me zhvillimin e mëtejshëm të vetëvlerësimit dhe përmirësimin e planifikimit në nivel lokal dhe kombëtar.

9 ROLET DHE PËRGJEGJËSITË NË VLERËSIM

9.1 *Nxënësit:*

- angazhohen aktivisht në procesin e të nxënësit;
- vlerësohen si pjesë e të nxënësit të përditshëm përmes një sërë veprimtarish, përfshirë dialogun dhe ndërveprimin me bashkëmoshatarët dhe mësuesit, kërkimet praktike, demonstrimet, prezantimet me gojë, diskutimet;
- vlerësohen përmes punëve me shkrim dhe produkteve të tilla, si veprimtari krijuese, raportime, projekte;
- demonstrojnë njohuritë, shkathësitë dhe qëndrimet përmes një sërë të dhënash, përfshirë detyrat e vlerësimit, veprimtaritë, testet dhe provimet;
- planifikojnë dhe rishikojnë të nxënësit e tyre përmes reflektimit, vendosjes së qëllimeve të të nxënësit dhe përcaktimit të hapave të mëtejshëm të të nxënësit personal;
- rishikojnë të nxënësit e tyre përmes vetëvlerësimit;
- bashkëpunojnë në vlerësimin e bashkëmoshatarëve;
- kontribuojnë në moderimin e vlerësimit.

9.2 Mësuesit dhe stafi drejtues:

- planifikojnë, hartojnë dhe kryejnë vlerësime, si pjesë e vazhdueshme e procesit të të nxënës dhe mësimdhënies, dhe në mënyrë periodike përdorin vlerësime specifike, teste ose provime;
- sigurojnë që vlerësimi të mbështesë të nxënës dhe të bazohet në një bazë të dhënash, të cilat gjykojnë përkundrejt rezultateve të pritshme dhe nxënësin progres, gjerësi dhe thellësi në procesin e të nxënës;
- punojnë me kolegët për të zhvilluar një kuptim të përbashkët për rezultatet e pritshme përmes veprimtarive, të cilat përfshijnë planifikim koherent, kontroll, përvojë, rishikim dhe feedback për përmirësim;
- përfshijnë nxënësit plotësisht në vlerësim dhe i ndihmojnë ato të kuptojnë çfarë pritët prej tyre;
- marrin pjesë në sigurimin e cilësisë, moderimin e veprimit, duke përdorur materiale të vlefshme për zhvillimin e ekspertizës së vlerësimit dhe për sigurimin e praktikave të vlerësimit të vlefshme dhe të besueshme;
- vlerësojnë të dhënat e të nxënës për të kontribuar në raportimin e arritjeve të nxënësve dhe progresin e tyre;
- raportojnë rezultatet e arritjeve të nxënësve për palët e interesit (nxënësit, prindërit, mësuesit, qeverisja lokale, institucionet profesionale, MAS, shoqëria civile etj.);
- informojnë prindërit/kujdestarin në kohë dhe në mënyrë të vazhdueshme për suksesin dhe vështirësitë e fëmijëve të tyre dhe i udhëzojnë ata si të ndikojnë në përmirësimin e rezultateve;
- shpjegojnë rezultatet e nxënësve duke marrë parasysh kushtet në të cilat janë arritur ato (socio - ekonomike, kulturore etj.);
- përgatitin raportime për arritjet në nivel klase ose fushe të nxënësi dhe i interpretojnë ato;
- shqyrtojnë veprime të ndryshme me synim përmirësimin e vlerësimit;
- kujdesen për besueshmërinë e informacioneve dhe përdorimin e drejtë të tyre.

9.3 *Prindërit:*

- përfshihen aktivisht në mbështetje të të nxënësve të fëmijëve të tyre;
- përfshihen plotësisht kur fëmijët dhe të rinjtë kërkojnë mbështetje përmes programeve individuale;
- marrin informacion të rregullt rreth anëve të forta të fëmijëve të tyre, progresit dhe arritjeve të tyre;
- informohen për boshllëqet dhe mënyrat përmes të cilave mund t'u vihet në ndihmë nxënësve;
- informohen për performancën e fëmijëve në shkollë përkundrejt niveleve të arritjeve në shkallë të veçanta në fushat e të nxënësve;
- sigurojnë mundësi që stafi të bashkëpunojë për planifikimet kurrikulare të të nxënësve, mësimdhënies dhe vlerësimit në mënyrë koherente për të siguruar thellësi, sfida dhe zbatim të të nxënësve;
- sigurojnë mundësi që stafi të diskutojë, të shkëmbejë përvoja dhe të zhvillojë kuptimin për rezultatet e pritshme përmes pjesëmarrjes në moderimin e vlerësimit (detjave);
- sigurojnë që veprimtaritë mësimore të përmbushin qëllimet dhe të jenë të menaxhueshme;
- sigurojnë që monitorimi dhe kontrolli i progresit të nxënësve mbështet të nxënësve të tyre;
- sigurojnë që vetëvlerësimi bazohet në një sërë të dhënash mbi të gjitha aspektet e të nxënësve.

9.4 *Autoritetet arsimore*

Kanë përgjegjësinë:

- të sigurojnë informacion për cilësinë e edukimit në shkollë dhe standarde të përshtatshme në edukim;
- të mbështesin vetëvlerësimin dhe përmirësimin e proceseve;
- të sigurojnë që shkollat kanë infrastrukturën e nevojshme për të mbështetur gjykimet e mësuesve dhe të fokusohen në veprimet e nevojshme për përmirësim;
- të lehtësojnë rrjetet lokale dhe të kontribuojnë në veprimtaritë mësimore përmes përfshirjes së partnerëve në sektorë të ndryshëm;

- të lehtësojnë zhvillimin e një bashkëpunimi efektiv ndërmjet autoriteteve arsimore dhe partnerëve dhe të lidhin praktikat lokale me ato në nivel kombëtar;
- të sigurojnë mundësi që shkollat të përmbushin rezultatet e pritshme;
- të sigurojnë që informacioni i vlerësimit përdoret në mënyrën e duhur për të inkurajuar stafin e shkollës, me synimin që ai të reflektojë për lidhjet ndërmjet praktikës së klasës dhe rezultateve të pritshme të nxënësve, për përmirësimin e mëtejshëm të tyre.

10 FJALORI I VLERËSIMIT TË NXËNËSIT

<i>Nr</i>	<i>Termet</i>	<i>Përkufizimi</i>
1.	Besueshmëri në vlerësim	Masa në të cilën një vlerësim, i përsëritur në kushte të ngjashme, do të arrijë të njëjtin rezultat.
2.	Drejtësi në vlerësim	Procesi i vendosjes së standardeve për vlerësimin e përgjigjeve të nxënësve në detyra të ndryshme, në mënyrë që të dhënat e nxjerra të jenë të besueshme dhe të vlefshme për qëllimet e synuara. Në shkollë, drejtësia nënkupton diskutimin e stafit të mësuesve për detyrat dhe punët e nxënësve në raport me standardet e përcaktuara dhe përcaktimin e nivelit të arritjeve për çdo detyrë të nxënësit (me marrëveshje të mësuesve).
3.	Nivel arritjeje	Një deklaratë që përcakton masën në të cilën është arritur rezultati i të nxënësit ose nivelin e njohurive dhe të kompetencave kyçe.
4.	Paanshmëri në vlerësim	Paanshmëria në vlerësim i referohet nevojave dhe karakteristikave të nxënësit dhe çdo mjeti të arsyeshëm që përdoret duke i marrë parasysh ato. Është e rëndësishme që të sigurohen mundësitë që nxënësi të informohet, të kuptojë, të marrë pjesë në procesin e vlerësimit dhe ta pranojë e miratojë atë si të përshtatshëm. Paanshmëria në vlerësim përshin edhe të drejtën e nxënësit për të kundërshtuar rezultatin e vlerësimit dhe të rivlerësohet, nëse shihet e nevojshme.
5.	Përgjegjësi dhe llogaridhënie	Proces në të cilin aktorët njohin, marrin përgjegjësi dhe japin llogari për vendimet, veprimet dhe pasojat e tyre. Llogaridhënia është e rëndësishme sidomos në kontekstin e decentralizimit të sistemit arsimor, i cili nxit autonominë shkollë, duke përfshirë edhe vendimet në lidhje me kurrikulën.
6.	Rezultat të nxëni	Termi ka kuptim të dyfishtë. Së pari, është deklaratë që përshkruan atë se çfarë duhet të dinë, të vlerësojnë dhe të jenë në gjendje të bëjnë si duhet nxënësit. Së dyti, u referohet njohurive të reja, kompetencave etj., që ndërton dhe përsos personi/grupi, pasi përmbyll nivelin arsimor. Rezultati i të nxënësit është koncept kyç për hartimin e mjeteve që mundësojnë

		transparencën, krahasimin, transferimin dhe njohjen e kualifikimeve në mes vendeve të ndryshme, në nivele të ndryshme.
7.	Teknikë vlerësimi	Teknika e vlerësimit ka të bëjë më mënyrën se si vlerësohen arritjet e nxënësve, e cila përfshin matjen direkte (teste, punët e nxënësit, detyrat, prezantimet, dosjen etj.) dhe matjen indirekte (vetëvlerësime, vëzhgime, intervista etj.)
8.	Test	Një provim ose vlerësim që përdoret për të matur njohuritë dhe shkathtësitë e fituara nga nxënësi. Testet mund të hartohen dhe zhvillohen nga mësuesit ose nga një agjenci e jashtme.
9.	Testim i standardizuar	Teste që hartohen, zhvillohen dhe vlerësohen në kushte të barabarta, sipas disa procedurave të hartuara në mënyrë të tillë që të sigurojnë rezultate të qëndrueshme, të cilat mund të shërbejnë për të bërë krahasime.
10.	Vlerësim	Vlerësimi në arsim është procesi gjatë të cilit gjykohet mbi bazën e një kriteri për vlerën e një rezultati arsimor, mbi bazën e informacioneve të grumbuluara nga procesi i të nxënësit.
11.	Vlerësim për të nxënësit/Vlerësim formativ	Vlerësim i kryer gjatë gjithë procesit mësimor me qëllim nxitjen e procesit të të nxënësit. Ky vlerësim e sheh të nxënësit si proces e jo vetëm si rezultat. Nxënësit ndërgjegjësohen për pikat e forta dhe nevojat në procesin e të nxënësit dhe u jepet mbështetja e duhur për të kapërcyer vështirësitë në procesin e të nxënësit.
12.	Vlerësim i të nxënësit/Vlerësim përmbledhës	Vlerësim i arritjeve të nxënësve për të siguruar informacion në lidhje me progresin e tyre (arritjet e tyre në fusha të ndryshme të kurrikulës /lëndëve mësimore dhe zotërimin e kompetencave). Ky proces shpesh përfshin përdorimin e testeve të standardizuara dhe përdoret për qëllime promovimi ose diplomimi.
13.	Vlerësim i performancës së nxënësit	Vlerësim që projektohet për të matur dhe gjykuar çfarë nxënësit dinë dhe janë të aftë të bëjnë duke u bazuar në mënyrën se si ata kryejnë detyra të caktuara.
14.	Vlerësim i brendshëm	Vlerësimi që kryhet rregullisht nga mësuesit në klasë si pjesë e mësimin të tyre dhe e metodologjisë së mësimdhënies. Ai ofron informacion rreth cilësisë së

		të nxënës dhe mbështet përmirësimin e tij të vazhdueshëm.
15.	Vlerësim që i referohet kritereve	Vlerësim i progresit dhe i arritjeve të nxënës duke iu referuar një grupi kriteresh të përcaktuar më parë.
16.	Vlerësim diagnostikues	Vlerësim që identifikon nivelet e arritjeve të nxënësve, për të orientuar mësimin drejt plotësimit nevojave të tyre për nxënie.
17.	Vlerësim kombëtar i arritjeve të nxënësve	Një ushtrim, një detyrë ose një veprimtari që zhvillohet në nivel kombëtar për të përcaktuar dhe matur arritjet e nxënësve në një fushë të nxëni ose lëndë mësimore. Në këtë lloj vlerësimi mbledhen të dhëna për nivelin e arritjeve të nxënësve në sistemin arsimor në tërësi, në një moshë ose klasë të caktuar. Normalisht këtu përfshihet edhe administrimi i testimit që zhvillohet për të gjithë nxënës të një niveli arsimor ose për një pjesë të tyre (me kampionim).
18.	Vlerësim i jashtëm i nxënës	Një proces dhe metodë vlerësimi që e zhvillon dhe e përdor një agjenci apo organ vlerësues (jo shkolla). Ky proces zakonisht përfshin testimin e standardizuar dhe shpesh shërben për të klasifikuar kandidatët për mundësitë e mëtejshme arsimore dhe për qëllime certifikimi.
19.	Vlerësim i nxënësve për njëri-tjetrin	Vlerësim i një pune ose një detyrë të nxënës nga nxënës të tjerë të klasës.
20.	Vlerësim i portofolit (dosjes) të nxënës	Vlerësim i koleksionit të punimeve të nxënës (detyra ose punë me shkrim, skica, punë artistike, prezantime etj.) të cilat pasqyrojnë zotërimin e kompetencave dhe progresin e nxënës.
21.	Vetëvlerësim i të nxënës	Vlerësim nga i cili nxënës mbledh informacion dhe reflekton rreth të nxënës të tij; gjykon për të në raport me objektivat dhe kriteret e vendosura; identifikon përparësitë e dobësitë dhe i përmirëson në përputhje me rrethanat.